

**RËNIA E PERANDORISË OSMANE 1878-1923: VËSHTRIM POLITIKO-
KULTUROR**

**TEMA PËR TITULLIN MASTER TË HISTORISË
NGA**

ALBIN JUSUFI



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË**

SHKURT, 2025

EKspoze e Temës

Rënia e Perandorisë Osmane 1878-1923: Vështrim Politik-Kulturor

Mentori: Prof.Ass.Dr.Mentor Hasani

Kandidati: Albin Jusufi

Tema e titulluar “Rënia e Perandorisë Osmane 1878-1923- Vështrim Politik-Kulturor” përbën një studim historik dhe hulumtim cilësor i cili koncentrohet në dyzetepesë vitet më kruciale dhe më determinuese të Perandorisë së fundit Islamike në histori të njerëzimit. Për herë të parë në histori të saj, bota Islame u ballafaqua me një krizë politike, dekadencë morale, pasiguri sociale dhe ngecje e depresion ekonomik të pa provuar më parë, ku rrethanat diplomatike dhe humbjet territoriale të cilat erdhën si pasojë e dështimeve luftarake të njëpasnjëshme rezultuan edhe në rënien përfundimtare të saj dhe krijimin e shteteve të reja të bazuara në idetë moderne perëndimore të sekularizmit, kapitalizmit, socializmit dhe nacionalizmit, ku pikërisht qytetërimi që prodhoi këto sisteme në fjalë ishte rivali historik më serioz i botës Islame.

Megjithatë, Perandoria Osmane nuk ishte e vetmja e cila u ballafaqua me ideologjitë e lartpërmendura moderne, por njëkohësisht edhe vet tokat e perandorive evropiane të krishtera të karakterizuara me rend konservator, autokratik dhe monarkik si Austro-Hungaria dhe Rusia Cariste. Të trija këto perandori religjioze u udhëhoqën nga dinasti shekullore si ajo e Rumanovëve, Habsburgasve dhe Osmanëve të cilat historikisht kanë luajtur një rol të rëndësishëm në balancimin e pushteteve në koncertin e politikave evropiane, ku traktatet dhe vendimet midis këtyre tre perandorive kanë përcaktuar fatin e popujve të tjerë që ishin pjesë e tyre. Të trija perandoritë u karakterizuan me një diversitet të shquar fetar, etnik dhe lingvistik.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të sqaroj situatat dhe marrëdhëniet diplomatike kryesisht midis këtyre tre perandorive në fjalë, ku secila prej këtyre perandorive posedonte plane ekspansioniste, ku pikërisht si pasojë e përpjekjeve hegjemoniste të tyre, u përmbysën edhe së bashku pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Të trija perandoritë e rivalizonin njëra-tjetrën dhe synonin që të sundonin territoret ku shtrihej njëra apo tjetra perandori.

Marrëdhëniet diplomatike dhe rivalitetet ideologjike së bashku me përplasjet fetare midis këtyre perandorive përbëjnë një prej boshteve më të rëndësishme për studim në shkencën e historisë,

pasiqë brenda këtyre tre perandorive u caktua edhe fati i qindra popujve të tjerë. Prezenca dhe impakti i perandorive vërehet tek këta popuj edhe në periudhën aktuale, sikurse në aspektin politik njëashtu edhe në atë kulturor.

Identifikimi dhe klasifikimi i situatave të komplikuar të lartpërmendura, është edhe qëllimi kryesor i këtij punimi, i cili do të përpiqet që të sqaroj dhe të hedh dritë mbi kompleksitetin e këtyre ngjarjeve. Shembulli më i saktë që e dëshmon këtë konfuzion kompleks gjendet tek rivaliteti i Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungarisë, të cilat ishin historikisht armike shekullore të njëra-tjetrës por që ranë së bashku duke qenë aleate. E njëjta gjë dëshmohet edhe tek marrëdhëniet midis Rusisë dhe Austrisë, të cilat ishin aleate shekullore të njëra-tjetrës por që dështuan së bashku duke qenë armike.

Aspekti kulturor dhe diversiteti brenda Perandorisë Osmane, pasojat e vendeve myslimane, kolonizimi i Lindjes së Mesme dhe ndikimi i politikës në kulturë dhe kulturës në diplomaci janë gjithashtu pjesë të rëndësishme të përfshira në këtë punim. Së bashku me hulumtimin e ngjarjeve të kaluara historike, ky punim do të dhuroj edhe një analizë të ndikimit të Perandorisë Osmane në shtetet aktuale të cilat ishin pjesë të saj, me theks të veçantë në Turqinë Moderne, Ballkanin dhe Lindjen e Mesme, ku do të përpiqet të sqarohet ndikimi i të kaluarës osmane në periudhën aktuale, dhe studimi i alternativës neo-Otomane për ta unifikuar dhe balancuar botën Islame nga konflikti dhe kriza në të cilën e ka kapluar, ku dyzetepesë vitet e fundit të periudhës osmane paten efekt në formësimin modern të botës Islame, i cili ishte i panjohur më parë.

Punimi në fjalë është i ndarë në katër kapituj kryesorë:

Kapitulli I: Skena politiko-kulturore në botën osmane dhe diplomacitë e Fuqive të Mëdha në fund të shekullit të XIX

Kapitulli i parë i këtij punimi fokusohet në strukturën e brendshme të shtetit Osman, politikat e Sulltan Abdul Hamitit II dhe ofron një përshkrim të popujve të Perandorisë Osmane gjatë fundit të shekullit XIX. Në këtë kapitull sqarohen raportet diplomatike të Perandorisë Osmane me Fuqitë e Mëdha, e me theks të veçantë trajtohet lufta Ruso-Turke e vitit 1877 dhe pasojat politike dhe kulturore që solli ky konflikt në gjeopolitikën osmane. Në kapitullin e parë sqarohet gjithashtu interesimi dhe ndikimi i Fuqive të Mëdha në pavarësinë e popujve të Ballkanit gjatë fundit të shekullit XIX.

Kapitulli II- Ngjarjet dhe rrjedhorat politiko-kulturore që dërguan në rënien e Perandorisë Osmane

Në kapitullin e dytë të këtij punimi trajtohen situatat dinamike dhe polemikat politike të fillimit të shekullit të XX, ku ky kapitull përbën njëkohësisht periudhën kohore e cila dërgoi në fundin e Perandorisë Osmane. Në këtë kapitull sqarohet Revolucioni Xhonturk, aneksimi i Bosnjës nga Austria, dhe strategjitë politike të Perandorisë Osmane të cilat rezultuan me involvimin e saj në Luftën e Parë Botërore. Kapitulli i dytë fokusohet në traktatet diplomatike të fundit të Luftës së Parë Botërore, veçanërisht me traktatin e Sevresit, Lozanës, ndërhyrjes ndërkombëtare dhe krijimin e Turqisë Moderne. Kapitulli në fjalë studion edhe shkaqet, rrjedhojat dhe rezultatet të cilat dërguan transformimin e Perandorisë Osmane në Turqinë Moderne.

Kapitulli III- Pasojat e popujve të Perandorisë Osmane gjatë dhe pas rënies së saj

Kapitulli i tretë i punimit koncentrohet në dimensionin humanitar dhe social të rënies së Perandorisë Osmane, veçanërisht gjatë dhe pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Ky kapitull hedh dritë në ngjarjen më të errët dhe më tragjike të fundit të Perandorisë Osmane, e cila ka të bëjë me masakrën armene të vitit 1915, ku edhe njihet kryesisht si gjenocidi i parë i shekullit të XX. Në këtë kapitull trajtohet edhe gjendja e popujve myslimanë me rënien e Perandorisë Osmane, e cila sikurse ajo e popujve të krishterë u shoqërua me spastrime etnike, retorikë anatemuese dhe persekutime të dhunshme. Kapitulli i tretë përmbyllet me kolonizimin e Lindjes së Mesme nga shtetet e Antantës, marrëveshjen Sykes-Picot, deklaratën e Balfurit për çështjen hebreje në Palestinë dhe pozicioni i Turqisë Moderne në raport me këto vendime.

Kapitulli IV- Ideologjitë politike të cilat ndikuan në rënien e Perandorisë Osmane dhe trashëgimia osmane

Kapitulli i katërt bazohet kryesisht në studimin dhe analizimin e ideologjive politike dhe kulturore të cilat ndikuan në rënien e Perandorisë Osmane. Këndvështrimet e këtyre ideologjive dhe përjashtimi i periudhës osmane si pjesë e “prapambetur” e identiteteve moderne, përbën edhe unanimitetin më të shquar midis nacionalizmit turk, ballkanik, arab dhe atij pan-Sllavist. Pjesa e fundit e këtij kapitulli hulumton gjithashtu një anë tjetër të historisë osmane, e cila hedh në dyshim tërë përshkrimin dhe qasjen e njëanshme të këtyre ideologjive. Në pjesën e fundit të kapitullit, trajtohet trashëgimia osmane, alternativa dhe qasja neo-Osmane për botën Islame, reaksioni i shteteve të cilat ishin pjesë e Perandorisë Osmane ndaj politikës së jashtme neo-Osmaniste dhe ndikimi i të kaluarës osmane tek këta popuj. Në këtë kapitull mbrohet teza që sikurse versioni neo-

Osman njëashtu edhe ai nacionalist lidhur me interpretimin e historisë së rënies së Perandorisë Osmane janë qasje të cilat kalojnë në ekstremitete të kundërta dhe në kontradikta të palejuara shkencore të njëanshme, të cilat i bëjnë edhe më pak faktuale në rrethin shkencor të hermeneutikës historike.

Si përfundim, ky punim përpiqet që të dhuroj një kontribut modest në fushën e historisë së Perandorisë Osmane, diplomacive të shteteve perëndimore në raport me të, planet dhe propozimet e ofruara për shpëtimin e Perandorisë Osmane, ideologjitë të cilat e motivuan rënien e saj dhe pasojat enorme humanitare të cilat u ballafaquan popujt e saj. Punimi i identifikon instrumentalizimet subjektive të ngjarjeve mesjetare historike, ku u përdorën si mjet për të ndërtuar ideologjitë nacionaliste kundër Perandorisë Osmane. Në këtë punim vendoset në dyshim çdo thjeshtëzim i historisë me prapavija politike dhe hulumtimi sqaron pasojat dhe rrezikun që përbëjnë selektimi i disa ngjarjeve pozitive dhe mohimi i disa ngjarjeve negative brenda shtetit Osman. Interpretime të tilla të historisë, shtuan dhe shtojnë armiqësinë midis popujve dhe dërguan e mund të dërgojnë në pasoja të rënda njerëzore të shoqëruara me dëbime dhe persekutime fetare, etnike dhe racore. Përveç që kjo qasje nuk është pragmatiste, ajo nuk prodhon as produktivitet racional dhe shkencor. Prandaj, si konkluzion punimi i historisë së viteve të fundit të Perandorisë Osmane, mbështet interpretimin dhe qasjen shumë-dimensionale për shtetin Osman, duke i shpjeguar rrethanat, ngjarjet dhe rrjedhojat në kohë dhe hapësirë dhe duke e çliruar historinë shkencore sikurse nga ideologjitë nacionaliste njëashtu edhe nga interpretimet imperialiste dhe glorifikuese për të kaluarën e shtetit Osman, ku e vetmja peshore për të dyjat është konteksti kohor, i mbështetur në metodologjitë shkencore dhe racionale.